



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SELENICË
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTIMIT
SEKTORI I PROJEKTIMIT

Selenicë, më 11 / 05 / 2026

MIRATOHET

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Nertil BELLAJ



DETYRË PROJEKTIMI

Për objektin:

“PROJEKT I RIKONSTRUKSIONIT TË RRUGËS SË FSHATIT MESAPLIK ”

BASHKIA SELENICË

Gjëndja e infrastrukturës në këtë objekt paraqitet:

a) Infrastruktura rrugore


Rruga me një korsi me një gjatësi rreth 1.94 km


Aktualisht kjo rrugë ka një trup me një gjerësi që luhet nga 2.5 deri në 3.5 m me shtresa të pa sistemuara. Nevojitet ndërtimi i saj sipas parametrave teknike të ndërtimit të një rruge. Kjo rrugë kërkohet të projektohet me një gjerësi të asfaltit prej 4m, me bankina me çakëll në të dy krahët me gjerësi nga 1m dhe kanal anësor të veshur me beton që mund të variojë në një gjerësi që shkon deri në 1-1.5 m, në një pjesë të rrugës, si dhe ndërtimin e një ure që do të zëvendësojë urën Beil që shtrihet mbi përroin e Shalsit. Të gjitha shtresat dhe nënshtresat si dhe ndërtimi i të gjitha veprave të artit (kanalit anësor, tombinove me diametra të ndryshëm sipas rastit, mure mbajtës ose pritës), si dhe urës, të projektohen në bazë të përlogaritjeve referuar (raportit gjeologjik të truallit, ngarkesave dinamike që veprojnë në trupin e rrugës, shpeshëtisë së kalimit të mjeteve në këtë rrugë, prurjeve të ujërave gjatë ditëve më problematike të vitit etj).

Foto të gjendjes ekzistuese











b) Kanalizimet e ujërave të zeza

Nuk ka një kërkesë specifike për disiplinimin e ujërave të zeza, nëse do të jetë e nevojshme pranë objekteve (nëse ka buzë rrugës), mund të lihen tubacione të kalimit nga njëra anë në tjetrën të rrugës.

c) Kanalizimet e ujërave të bardha

Nuk ka një rrjet ekzistues të Ujërave të Bardha por që të gjitha këto ujëra në varësi të terrenit do të disiplinohen në kanal in anësor.

d) Rrjeti ujësjellësit

Nuk ka informacion nëse ka një rrjet ekzistues apo jo. Nevojitet marrje informacioni pranë UK.

e) Rrjeti ndriçimit rrugor

Nuk ekziston ndriçimi rrugor.

2. Kërkesa të veçanta

Nuk ka kërkesë specifike pasi aksi i rrugës është pothuajse i përcaktuar dhe nuk do të ketë devijime të mëdha, do të ruhen kërkesat specifike për kufinj të lejuar të pjerrësisë së rrugës. Kërkesa specifike qëndron në vlerësimin e gjëndjes së urës Beil në afërsi të fshatit Mesaplik, mbi përrua. Mundësinë e zëvendësimit të saj me urë me strukturë betoni.

a) Infrastruktura rrugore


Rruga të trajtohet sipas gjerësisë të trupit të rrugës të përcaktuar 4 m asfalt + 2x1 m bankinë me çakëll. Shtresat rrugore të trajtohen të tilla që të sigurojnë garanci, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të prespektivës. Në pika të veçanta duhet të përcaktohen vende për shkëmbim mjeteve. Gjithashtu pjesa e parashikuar brenda fshatit të trajtohet me gjerësi 4m + 0.5 m kuletë me beton + 2 x 1 m trotuar në të dy anët. Përgjatë trotuarit të parashikohet ndriçim nga të dyja anët me hap çdo 15m.

Prerje tip e rrugës (vazhdim)

Materialet që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve.

Në përfundim mund të thuhet se projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Bashkinë përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme.

Prerjet tërthore tip (të propozuara)



Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi përpara se të fillojë punën me projektimin duhet që paraprakisht:

1. Të bëjë relievin (azhornimin) e rrugës; të jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
2. Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës, etj, sipas Formularit 3/1;
3. Projektuesi duhet të bëjë verifikimi paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës, përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në mënyrë që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra që nuk përputhen me gjendjen në terren.
4. Të bëjë studimet përkatëse gjeologjike, hidrologjike etj (sipas kërkesave të projektimit dhe Formularit 3/1).

b) Sinjalistika

Sinjalistika do të përfshijë sinjalistikën vertikale dhe horizontale. Për sinjalistikën horizontale do të përdoret bojë speciale bikomponente. Pranë kthesave të vendosen shtylla njoftuese, sinjalistikë vertikale.

c) Ujësjiellësi

Në bashkëpunim me Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. do të saktësohet linja e ujësjiellësit të zonës nëse ka .

3. Hartimi i Preventivit

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, çmimet e përdorura duhet të jenë sipas manualit teknik në fuqi dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas formatit/ modelit të manualit nga sistemi i integruar i manualit të çmimeve dhe hartim preventiv/situacioni dhe analiza teknike duke u bazuar në “Manualin Teknik të Çmimeve” të miratuar V.K.M. Nr.216 datë 13.04.2023.

4. Standartet

Standarte në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi të përdorë programet e kërkuara

kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihet parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

5. Realizimi i Projektit

Fazat e projektimit për këtë objekt sipas VKM nr. 354 datë 11.05.2016 janë:

- Faza IV - Projekti për miratimin e Lejës së Ndërtimit.
- Faza V - Projekti i Zbatimit.
- Faza VI - Preventivi Përfundimtar.

5.1. Faza IV (Projekti për miratimin e Lejës së Ndërtimit)

Paraqitja e varianteve të ndërhyrjes, në bazë të rezultatit të vlerësimit ekonomiko-financiar, skemës së qarkullimit, trashësisë së shtresave, gjerësisë së kanalit anësorë kullues, llojit të tombinove etj, mureve mbajtës (pritës).Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse duke përfshirë volumet, llojin e shtresave dhe trashësinë e tyre për çdo variant etj. Përpunimi dhe dorëzimi i dokumenteve për procedurat e nevojshme juridike e ligjore (Licenca, certifikata, policë sigurimi, projekt etj, të vulosura me vulë dixhitale)

5.2. Faza V (Projekt Zbatimi)

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit për objektin “ Rikonstruksion i rrugës së fshatit Mesaplik (Njësia Administrative Brataj) i cili duhet të përmbajë:

1. Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:
Raportin teknik, ku për veç llogaritjeve, do të jepen llogaritjet e shtresave, të dhëna të sakta, bazuar në teste për gjendjen ekzistuese, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, , siguria e kalimit në rrugë dhe masat që duhet të merren për rregullimin e trafikut gjatë punimeve të ndërtimit, Specifikimet Teknike për ç'do zë pune.
 - Metoda e llogaritjes së shtresave të jetë e bazuar në CBR.
 - Preventivi i plotë i kushtimit të veprës.
2. Raporti gjeologjik
3. Horografi e rrugës.
4. Hartimi i relievit topografik të rrugës (koordinata lokale, kuota absolute)
5. Planimetrin e rrugës (Skema e qarkullimit), zbatimi i trases së rrugës, përfshirë kanal in anësor kullues, muret.
6. Profilin gjatësor të rrugës, urës, kanalit.
7. Profilat tërthorë të rrugës, urës, kanalit.
8. Planimetri e urës (nëse do të vlerësohet që do të zëvendësohet)
9. Detajet të ndriçimit, armimit të kanalit, urës, mureve dhe vendosjes së tombinove.
10. Sinjalizimin vertikal dhe horizontal.
11. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
12. Plan organizimim e punimeve.
13. Ngritja e kantierit.

14. Raportin e vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
15. Grafiku i punimeve.
16. Preventivin e punimeve bazuar në manualin e çmimeve të miratuar sipas Vendimit Nr. 216 /2023 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", shoqëruar me analizat e çmimeve për zërat që nuk janë në manual (nëse ka).
17. Planimetri të ndriçimit + relacion dhe specifikime për punimet e ndriçimit

5.3. Faza VI - Preventivi Përfundimtar.

Preventivi i punimeve duhet të vijë sipas formatit të bazuar në manualin e çmimeve të miratuar sipas Vendimit Nr. 216 /2023 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" dhe i firmosur elektronikisht.

6. Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimum fletët si më poshtë:

Paraqitja e vizatimeve

1. Topografin e gjëndjes egzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje, nëse ka) ne Shk. 1:500 ose 1:1000
2. Horografia e përgjithshme e zonës në format jo më të vogël se A3:
3. Planimetria e sistemimit të rrugës në Shk. 1:500 ose 1:1000
4. Planimetria e kanalit anësor në shkallë 1:500 ose 1:1000
5. Detaje të mureve, armimi, planimetria, planvendosja, planimetria e ndriçimit
6. Profili gjatësor i rrugës, urës Shk. 1:1000, 1:100.
7. Profilat tërthorë të rrugës, urës jo më pak se 25 m
8. Detaje konstruktive tip të shtresave të rrugës, urës, kanalit.
9. Detaje të vendosjeve të tombinove, detaje të ndriçimit
10. Kryqëzimet dhe detaje përkatëse.
11. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve (nëse ka)
12. Planimetri dhe detaje për levizshmeri/sinjalistikën rrugore.
13. Plan-organizimi i punimeve në format A3;
14. Në format A4:
 - Relacioni teknik + relacion për punimet e ndriçimit
 - Relacion topografik
 - Raporti gjeologo-inxhinierik
 - Llogaritjet
 - Specifikimet teknike + specifikimet për ndriçimin
 - Raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM)
 - Grafiku i punimeve
 - Preventivi me dhe pa çmime
 - Marrjen e masave të sigurimit Teknik si të punëtorëve ashtu edhe të publikut.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me rrugën.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia

Selenicë, seksioni i Urbanistikës dhe nga Kadastra.

- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.

7. Dorëzimi i Projektit

- Mënyra e dorëzimit

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje origjinale në format PDF, si dhe në version të dixhitalizuar në CD, ku një CD do të përmbajë punimet në DWG, Office Word-Excel dhe një CD do të përmbajë të gjithë dokumentacionin në format PDF. Të gjithë dokumentacionet që do të përmbajë CD-ja sipas formatit PDF do të jenë të firmosura elektronikisht sipas kërkesave për pajisje me leje ndërtimi të përcaktuara në bazë të ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territori", si dhe VKM-së Nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori", të ndryshuar.

- Afatet e dorëzimit

Afati për hartimin e Projekt zbatimit dhe të preventivit përfundimtar do të jetë jo më vonë se 60 (gjashtë dhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës.

- Kërkesa të veçanta

Projektuesi duhet të jetë i gatshëm të bashkëpunoj me Bashkinë Selenicë për çdo ndryshim të mundshëm që do të dal gjatë implementimit të projektit në terren.

Punoi : Ark. Fatjon Devollaj

Ing. Deana Çeçi

Ark. Katerina Tralo

